



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 22.7.2015, në orën 12:45

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Munguan:

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Tringa Bytyqi-GLPS, Lejla Selimi-OSBE, Albert Selimi-YIHR-KS dhe Arta Xhylani, praktikante në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër;
3. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë për Barazi Gjinore;
4. Shqyrtimi i Udhëzuesit për Peticione;

5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër, të shqyrtohet më vonë pasi që raportuesja Salihe Mustafa, vonohet pak dhe fillimisht të shqyrtohet Raporti i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Udhëzuesit për Peticione, e pastaj pika e dytë.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë për Barazi Gjinore

Kryetarja- Tha se raportin e keni marrë me kohë, janë prezantuar aktivitetet e Agjencisë për Barazi Gjinore, ka disa vërejtje rreth stafit ripozicionimeve të brendshme. Në raport janë paraqitur mjaft të dhëna, është duke u punuar rregullorja për përcaktimin dhe njohjen procedurave dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Agjencia në këtë drejtim është mjaft e angazhuar, gjatë kësaj faze, sa punohet, është mirë ta shohim edhe ne progresin që po arrihet në këtë drejtim dhe shumë çështje të tjera që janë cekur si sfida, dhe për këtë është mirë për ta mbajtur një tryezë të përbashkët me aktorët përgjegjës për ta diskutuar këtë raport.

Valdete Bajrami- Pyeti se ky aktivitet a është i paraparë në Planin e Punës së Komisionit.

Teuta Haxhiu- Pyeti se raporti i Agjencisë për Barazi Gjinore a do të procedohet në Kuvend për diskutim.

Kryetarja- Tha se me Planin e Punës së Komisionit është i përfshirë ky aktivitet, ndërsa ky raport nuk procedohet për debat në Kuvend sepse këtë nuk e parasheh ligji për Barazi Gjinore.

Kryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Komisioni në muajin shtator të organizojë tryezë të përbashkët me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe institucionet relevante që kontribuojnë në përkrahjen e politikave gjinore në Kosovë.

3. Shqyrtimi i Udhëzuesit për Peticione

Kryetarja-Tha se për këtë udhëzues kemi pasur dy punëtori dhe e kemi lenë mundësinë e hapur që nëse dikush nga anëtarët e Komisionit ka diçka për ta plotësuar, të sjellë me shkrim ato propozime, por deri tani nuk kemi pranuar ndonjë propozim, prandaj po e riaktualizoj këtë, në mënyrë që në fund të muajit shtator të kemi këtë udhëzues të përfunduar.

Teuta Haxhiu- Tha se është punuar mirë deri tani në këtë drejtim, por nuk kam mundur me hasur në këtë udhëzues se si udhëzohen qytetarët të procedojnë më tutje, nëse nuk janë të kënaqur me përfundimin e Komisionit dhe Kuvendit, ku të adresohen pastaj. Kjo çështje duhet të jetë e rregulluar. Nuk e kam hasur se ku e ka të drejtën për ankesë qytetari pas vendosjes së çështjes në Kuvend.

Valdete Bajrami- Tha se nuk është mirë që prapë qytetarët të marrin nismë me dalë me nënshkruar petitionin përsëri.

Kryetarja- Tha se përfundimi i procedurës parashihet në rregullën 16 dhe 17, por nëse mendoni se duhet diçka më tepër, ne po diskutojmë në atë drejtim që të kontribuojmë qysh është më së miri për qytetarët, por gjithnjë duhet të veprojmë në pajtim me

fushëveprimtarinë e Komisionit deri në shtator, nëse mundeni edhe si deputetë me hulumtuar diçka dhe me kontribuar në këtë drejtim.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tha se pas gjithë asaj pune që është bërë dhe mbajtjes së dy punëtorive, është mirë të konsultohemi dhe ta finalizojmë këtë udhëzues komfor praktikave të aplikueshme të vendeve të zhvilluara, dhe të jetë një dokument me vlerë dhe derë e hapur për qytetarët tanë.

Mytaher Haskuka- Tha se kemi rastin e peticionit të punëtorëve të Grandit me njëqind nënshkrime, dhe peticione me mbi dhjetëmijë nënshkrime, kjo me dhjetëmijë nënshkrime merret edhe si nismë legjislative që ka të drejtë edhe nismën për ndryshim të ligjit, dhe në rastin kur kemi dhjetëmijë nënshkrime, ne duhet të propozojmë që pajtohemi të debatojmë apo jo në Kuvend.

Kujtim Paçaku falënderon anëtarët e Komisionit që punuan në punëtorinë në Gjakovë, ndërsa sa i përket çështjes së peticionit se ku duhet të ankohet personi, duhet të ndiqet forma e jurisprudencës apo gjyqit, që në çdo vendim, që sa duhet të ketë afat dhe kujt i drejtohet peticioni, sepse nuk duhet të varemi në numër shumë, por kujt i dorëzohet. Të konsultohen shtetet e rajonit, por, ne, si shtet që jemi, sikurse ka bërë edhe Mali i Zi që të jetë në natyrën e shtetit të Kosovës. Pas gjithë këtyre në shtator të dalim më konkretisht.

Valdete Bajrami - Thotë që nëse bëhet kërkesa për zyrën e hulumtimeve, atëherë të bëjnë përcjelljen e ndarjeve për të gjithë ne në email në mënyrë që mos të ngarkohet vetëm një person, por të kontribuojmë të gjithë.

Etem Arifi- Kërkon një vizitë studimore në një shtet, të shihet se si punohet në këtë aspekt, nëse do të ishte mundësia.

Lirije Kajtazi- Propozimin e z. Etem e aprovon, dhe tregon që ka kërkuar nga një organizatë për një vizitë si komision.

Kryetarja konstatoi se në fund të debatit për udhëzuesin e peticioneve Komisioni mori këtë

Përfundim

Komisioni kërkon nga zyra për hulumtime që deri në muajin shtator, të bëhet një hulumtim dhe krahasim, se pas përfundimit të shqyrtimit të peticionit në Komision dhe Kuvend, ku të drejtohen qytetaret e pakënaqur me vendimin që ka marrë kuvendi. Të bëhet një hulumtim dhe krahasim se si është e rregulluar në vendet e tjera.

2. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër

Kryetarja- Tha zonja Salihe të raportojë për monitorimin e zbatimit të ligjit për Persona të Verbër, si kryesuese e grupit punues. Por edhe propozuesit e rekomandimeve dhe propozimeve mund t'i sqarojnë nëse nuk i kanë të qarta çështjet.

Salihe Mustafa- Thotë se ka kërkuar që në këtë sesion të hyjë në Kuvend ky monitorim, por më raportin që ka parë nuk është e kënaqur. Administrata ka ndryshuar format e raporteve, duke u bazuar me raportet e tjera ky raport është si i mangët dhe nuk dëshiron të dalë një komision më një raport të dobët, sepse pa marrë parasysh që kanë dhënë propozime edhe formë të raportit këtu nuk po shihet siç ka qenë ai i zonjës Mexhide, mirëpo janë edhe vërejtjet konkrete të saj.

Teuta Haxhiu- potencoi disa propozime dhe vërejtje, siç është rasti që ka dhënë disa propozime të rekomandimet, ku rekomandimi i parë gjithsesi duhet të ndryshohet, duhet të janë konkretë në rekomandime. Të thuhet në rekomandimin e dytë: Të zbatohen dispozita "Deri në plotësim, ndryshimin e ligjit", sepse po bie në konflikt më pikën e parë, të plotësohen dhe ndryshohen dhe në pikën tjetër të zbatohen. Tutje, tjetër pikë për konsultim, të nxirren akte nënligjore, nuk është shumë adekuate si fjali për këtë monitorim, që dëshmon për një punë më efektive, duhet të potencohet më hapur kjo fjali. Pika tjetër e fundit, që nuk iu duket e përshtatshme "të vazhdojë të organizojë seminare" por ndoshta më mirë" të vazhdojë të mbajë seminare".

Reshit Gashi- Tha se është një formë unike e raporteve në Kuvend, që pranohet për të gjitha rekomandimet. Pastaj nëse ndryshohet dhe plotësohet ligji, atëherë cilat dispozita duhet cekur konkretisht. Pastaj për aktet nënligjore janë për ato që nuk zbatohen.

Teuta Haxhiu- kërkon të dijë se a ishin të specializuar mësime dhënësit në shkollat speciale për të verbër.

Mexhide Mjaku-Topalli tregon se ekzistojnë mësime dhënësit udhëtues, të trajnuar për shkollimin special.

Salihe Mustafa- Tha që vizitat e realizuara, me grup punues, ka mundur të ikin disa pyetje për të bërë, andaj edhe ka kërkuar të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit, në mënyrë që të kemi një raport efektiv, dhe e sheh që duhet vizita shtesë për këtë raport.

Mytaher Haskuka -dha vërejtje rreth nenit 7.3, se a duhet të ndryshohet dhe plotësohet apo duhet të zbatohet, si dhe duhet të theksohet për cilat nene duhet të ndryshohen apo cilat duhet të zbatohen.

Salihe Mustafa- i kërkoi falje administratës, por ajo që deshi është vetëm të kenë një raport të mirë kur raportohet në Kuvend, sepse pas kësaj pune të lodhshme, më ndërrime e përmirësime e prapë nuk është final, mendon që edhe raporti propozues i deputetes Mexhide është ndërruar.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se forma e raportit është e mirë dhe se gjithçka është në rregull.

Pas diskutimeve u vendos që raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të shikohet edhe një herë nga grupi punues, para se të shkohet me miratim në Komision, duke qenë se, raporti po mbetet të procedohet në sesionin vjeshtor.

4. Të ndryshme

Mexhide Mjaku-Topalli- thekson për takimin që ka realizuar më përfaqësuesit e BE-së, çështja e vizitave në komunat e Kosovës, ka raportuar se do të vizitohen qytetet e caktuara dhe zyrat e posaçme dhe që u ka pëlqyer dhe është në interes. Pika tjetër që tha është që të jetë i shënuar emri i saj aty ku është prezent dhe jo emri i tjetër kujt, apo edhe pa emër fare.

Ajo tha se do të marrë pjesë në një takim me shoqatat e personave të verbër.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi